



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 221/pj - 15248/23
Dt. 07.07.2023

Duke u bazuar në Vendimin e KKSBB-së, rekomandimin e Policisë së Kosovës, neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

I.I. Nga data 15.07.2023 nga ora 07:00 deri më dt. 20.08.2023 në ora 24:00 fillon së funksionuari rruga unazore e qytetit të Dragashit.

I.II. Rruga unazore do të jetë në funksion 24h gjatë kësaj periudhe.

II

Qarkullimi i vetuarve do të organizohet në rrugë një kahore në qytetin e Dragashit dhe do të kalojë në rrugën unazore e cila kalon nga f.sh. Shajnë dhe del në hyrje të qytetit të Dragashit. Organizimi i komunikacionit do të rregullohet me shenja të komunikacionit. Policia e Kosovës së bashku me Inspektoriatin Komunal do ta mbikqyrin dhe organizojnë komunikacionin.

III

Vendimi për këtë rrugë Unazore u nxjerrë pas Vendimit të KKSBB-së nga mbledhja e mbajtur me dt. 14.06.2023, si dhe rekomandimet e Policisë së Kosovës S.P. Dragash.

IV

OBLIGOHET Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Dragash së bashku me Inspektoriatin e Komunës që ta zbatojnë këtë vendim dhe të organizojnë qarkullimin e komunikacionit në qytetin e Dragashit.

V

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

- *Vendimi i 'u dërgohet:*
 - *Stacionit Policor në Dragash,*
 - *Inspektoriatit të Komunës,*
 - *Mjetet e Informimit (Radio Sharri, Tv Opoja, Radio Gora dhe Radio Bambus)*
 - *Arkivës së Kryetarit.*

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini